

TIMOLOGJIA LETRARE E BAJRAM KRASNIQIT

Hysen MATOSHI
Instituti Albanologjik
Prishtinë

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Kritika letrare dhe historia e letërsisë shqipe identifikojnë në gjysmën e dytë të viteve 70 një kapacitet interpretues e sintetizues me interes për vlerësimin dhe mendimin letrar shqiptar. Emri i Bajram Krasniqit vjen në letrat shqipe si një vetje premtuese, si një simbiozë që përbashkon në një talentin e rrallë interpretues me dijetarin e pajisur me njohuri të gjithanshme teorike e historiko-letrare që do t'i mundësojnë bërjen e sintezave mbi autorë, vepra, fenomene letrare, zhanre, mbi tipologjinë letrare dhe përgjithësisht mbi aspekte të kronologjisë zhvillimore të letërsisë shqipe. Përtej kësaj, faktet letrare shqipe, jo një herë, në studimet e tij, i vë në korrelacion me ato të letërsive të popujve përreth, madje edhe me vlera të përbotshme letrare. Që në veprën e tij të parë “Komunikime letrare” (Prishtinë, 1980) ai do të dëshmojë kapacitetet e tij aksiologjike nëpërmjet shenjave të qarta të formësimit të një timologjie vetjake letrare. Nuk është fjala vetëm për një lexim ndryshe të letërsisë, ngaqë Bajram Krasniqi, me vizionin e tij interpretues dhe njohës, ka ecur në rrugën e formësimit të një sistemi vetjak vlerësues. Kjo e bën që të veçohet si një kritik letrar dhe studiues letërsie me identitet të veçantë. Një autor që nuk ndoqi modele dhe që, fatkeqësisht, nuk u pasua si një model në kritikën tonë letrare dhe as në studimet tona letrare.

Fjalët çelësa: letërsia, romani, proza, kritika, timologjia letrare, Bajram Krasniqi .

Fillimet e Bajram Krasniqit, sa i përket botimit të librave, shënohen në vitin 1980, kur e botoi veprën e parë “Komunikime letrare”, që pa dritën në edicionin e “Rilindjes”. Vepra e tij prej 160 faqesh paralajmëronte një potencial premtues në fushën e interpretimit e të komunikimit studimor letrar te ne. Duke qenë një studiues i mirëfilltë, i talentuar dhe i formuar, që në fillim, ai do të dëshmonte edhe një kapacitet për t’i analizuar dhe për t’i sintetizuar shkencërisht çështjet për të cilat shkruan. Duke qëndruar larg proliksitetit, që jo rrallë i karakterizon interpretimet tona të lëndës letrare, shkrimi historiko-letrar dhe kritiko-letrar i Bajram Krasniqit është konciz, njëkohësisht elokuent si shprehje logjike e gjuhësore, por edhe si strukturë e ndërtuar në përputhje me metodo-lo-gjinë shkencore. Idetë dhe konceptet e tij letrare shpërfaqen nëpërmjet një ligjërimi që arrin të përmbajë sasinë e informacionit më të domosdoshëm komunikues, me çka ia del ta mbajë të fokusuar lexuesin në çështjet që i trajton. Logjika e tij, e thelluar dhe e përqendruar, nuk lejon ekskursione fragmentare, digresione, bredhje jofunksionale eksplikuese e teorizuese lidhur me aspekte të ndryshme të cilat mund të shfaqen në secilin tekst apo në secilin komunikim. Ky fakt ka bërë që, si autor i studimeve dhe i kritikave letrare, të mos dallohet për ndonjë gjatësi tekstesh dhe rrjedhimisht edhe studimet dhe librat e tij nuk bëjnë pjesë ndër punimet e gjata dhe ndër monografitë vëllimore. Konceptimi i këtillë racional i mendimit letrar, në një format të përmbledhur, shpërfaqet që në librin e tij të parë për t’i mbetur konsekuent kësaj metodologjie deri në shkrimet e fundit.

Këtë përcaktim prej studiuesi, Bajram Krasniqi e ka shpërfaqur edhe në pasfjalën e këtij libri. Ndonëse në një tekst të shkurtër dhe pasi e qartëson përmbajtjen duale të këtij vëllimi (“Romani – probleme dhe interpretime” dhe “Poetika e prozës së Ismail Kadaresë”), autori na ofron pikëpamjet e tij, të cilat pak a shumë mbesin bosht esencial dhe konsekuent i gjithë veprimtarisë së tij në fushën e shkencës së letërsisë: “...Në këtë libër janë përfshirë vetëm ata artikuj kritikë që shënojnë konceptcionin e caktuar të autorit për interpretimin letrar. Prandaj, edhe librin e titulluam *Komunikime letrare*, duke dashur në këtë mënyrë t’ia sugjerojmë lexuesit konceptcionin për interpretimin, si e kupton autori këtë dhe funksionin e tij për të vënë urën komunikuese ndërmjet veprës dhe lexuesit. Sado që gjatë interpretimeve letrare të përfshira në këtë vepër nuk është paraqitur rruga e librit deri te lexuesi dhe raporti vepra-konsumentit nuk është shpjeguar shkoqur, autori gjithnjë ka pasur parasysh këtë raport, *komunikimin* e veprës me lexuesin, gjë që edhe interpretimin letrar e konsideron hallkë të këtij zinxhiri. Duke qenë se inter-

pretimi letrar nuk ka një natyrë me interpretimin muzikor, ai nënkupton të menduarit në sistem, paraqitet si sistem mendimi për prodhimin letrar, i cili, në anën tjetër, vetë është *të menduarit me figura* për njohjen artistike të botës. Rrjedhimisht, interpretimi letrar nënkupton, në mos sistemin, një qëndrim aksiologjik ndaj veprës letrare, që është karakteristike për gjithë kritikën tonë letrare që nga zanafilla”.¹

Qartësisht synimi i autorit nuk është thjesht një paraqitje përshkuese e procesit letrar, e përshkrimit biobibliografik të shfaqjes së autorëve, dukurive e gjinive letrare ndër ne, pra nuk synon një paraqitje pozitiviste të kronologjisë letrare shqipe, përkundrazi është fjala për një vetëdije studiuësi që detyrën e tij e koncepton në kuadër të vlerësimit shkencor, të gjykimit racional për letërsinë shqipe, gjithnjë nëpërmjet krijimit të një rendi të këtyre vlerave.

Përgjithësisht kjo vepër, e botuar nga “Rilindja” në kuadër të bibliotekës së mirënjohur *Hejza*, me redaktor Sabri Hamitin dhe recensent Ibrahim Rugovën, është një hyrje në botën e kontributeve studimore për letërsinë dhe sprovë bindëse kritiko-letrare të Bajram Krasniqit në përgjithësi dhe lidhur me romanin shqiptar në veçanti. Kjo vepër nuk ishte vetëm një shenjë e qartë orientuese e përkushtimit studimor të autorit, por njëkohësisht ishte edhe dëshmi e kapaciteteve të dalluara profesionale, e njohjes teorike të çështjeve, e zotërimit të metodologjisë së studimit letrar, e konceptimit të kronologjisë letrare shqiptare (madje edhe asaj të përbotshme, kur është fjala për vlerat më kulmore e më përfaqësuese të saj), e njohjes dhe e zotërimit të terminologjisë letrare si dhe e përdorimit të saj të saktë. Sidomos në planin e terminologjisë së shkencës së letërsisë ai dëshmoi se do të krijonte në vijimësi edhe një pjesë të fjalësit vetjak me të cilin do të identifikohet në të gjithë veprën e tij shkencore dhe intelektuale. Pavarësisht prurjeve premtuese, kjo vepër e Bajram Krasniqit nuk shënon ndonjë arritje të rëndësishme të tij, ngaqë procesi i tij evolues drejt një dijetari të përmasave kombëtare të letërsisë do të bëhej realitet gjithnjë e më shumë gjatë viteve vijuese (vitet ‘80 të shek. XX) në mënyrë evolutive dhe me një ngjitje të vazhdueshme. Me kohë ai nuk do të ishte thjesht një kapacitet premtues në fushën e studimit të letërsisë shqipe dhe të kritikës letrare, ngaqë me monografinë “Poetika e romanit historik shqiptar” ai do të identifikohet si një faktor që do të riorientonte në shumëçka mendimin tonë shkencor mbi letërsinë, veçmas

¹ Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 160-161.

në planin historiko-letrar dhe tipologjik, i cili do të përcaktonte në planin metodologjik qasje, mjete e forma të reja studimi.

Megjithatë, sado modeste prurjet e tij shkencore e kritike letrare, sado punë entuziaste e një fillestari që po hynte në fushën e studimit të letërsisë, shkrimet e botuara në veprën “Komunikime letrare”, kundruar në kontekstin e përgjithshëm të studimit të letërsisë shqipe, janë me interes. Do të mundohemi të sjellim disa nga veçoritë e këtij libri, i cili në planin strukturor dhe përmbajtjesor sajohet nga dy pjesë, që në këtë format botimi komplementohen në mënyrë të ndërsjellë, por edhe mund të merren e të trajtohen si njësi të veçanta funksionale. Pjesa e parë, e titulluar “Romani- probleme dhe interpretime”, sajohet, kryesisht, nga shkrime kritiko-letrare për romane dhe autorë të caktuar të letërsisë shqipe, duke pasur edhe një shkrim hyrës që trajton aspekte të përgjithshme të romanit tonë bashkëkohor, përkatësisht aspekte-historiko letrare dhe aspekte tipologjike të romanit të kësaj periudhe. Ky tekst hyrës përbën një sprovë interesante sintetizuese, kundruall teksteve kritiko-letrare që kanë më shumë karakter interpretues të lëndës letrare, pra të romaneve të caktuara në këtë rast. Interpretimet dhe sintezat në këtë pjesë të librit, prej rreth 60 faqesh tekst, ndërliken duke e dhënë një pasqyrë më të plotë për autorin e tyre, por edhe një orientim për aspektet teorike e metodologjike të studimeve të tij letrare, përkatësisht të kritikave të tij letrare.

Duke qenë një ndër përdoruesit më të saktë të terminologjisë letrare, ndër studiuesit tanë të letërsisë përgjithësisht, ai kujdeset që të qartësojë domethënien e secilit prej zërave të saj, përkatësisht domethënien me të cilën ai i përdor termat. Në rend të parë, në këtë vepër bën dallimin ndërmjet togfjalëshit *roman bashkëkohor* dhe *roman modern*. Të parin e përdor në funksion të përkufizimit kohor të produktit letrar romanor, që nis me fillimin e viteve ‘60 e në vijim, pra me romanin e kohës së autorit të studimit, ndërsa të dytin si togfjalësh terminologjik që shënon një oponencë poetike kundruall romanit klasik. Në shpjegim e dhënë në fusnotë, Bajram Krasniqi kështu e definon këtë çështje: “Në studimet e letërsisë edhe sot e kësaj dite përzihen termet bashkëkohor dhe modern. Bashkëkohor është romani i kohës sonë, ndërsa për romanin modern shumë teorikë thonë se fillon me *Don Kishotin* e Servantesit për të përfshirë sigurisht edhe kohën tonë. Të tjerët konsiderojnë se ky roman

fillon me Xhojsin. Në anën tjetër termi modern ka edhe vështrim tipologjik dhe përdoret për t'u dalluar nga romani i mirëfilltë klasik”.²

Ndonëse e pranon faktin se zhvillimi i romanit kërkon një nivel më të lartë përparimi të përgjithshëm social e historik të një kombi, se rrethanat e përgjithshme i determinojnë ato specifike, Bajram Krasniqi del i vetëdijshëm se vetëm me këta faktorë nuk mund të shpjegohet gjerësisht tradita e lëvritit të prozës në letërsinë shqipe, ngase një qasje e tillë do të shpinte pashmangshëm në konceptimin pozitivist, tipik për metodën e realizmit socialist, që edhe ishte atëbotë dominuese, sipas shpjegimit vulgar të së cilës letërsia ishte produkt i thjeshtë i realitetit, ose formë e vetëdijes ideologjike. Duke bërë një kronologji të përmbledhur të romanit shqiptar që nga shfaqjet e para e deri në vitet '60, ai këtë qasje e quan si shumë të thjeshtëzuar dhe të tillë që nuk merr parasysh emancipimin estetik dhe nivelin e zhvillimit të procesit letrar te ne: “Aspektet e këtij romani do të kristalizohen në vitet '60 e këndeje, që do përbëjnë një tip të veçantë, një model letrar të parashtrimit të jetës. Që të pohojmë nivelin e tij dhe tendencat, qoftë edhe embrionale të zhvillimit të mëtejshëm të romanit tonë të sotëm, çështjen do ta vendosim në rrafshin historiko-letrar. Kjo dhe çështje të tjera që lidhen me të nuk mund të shpjegohen vetëm me rrethanat kulturore, sepse kështu do të shtroheshin në rrafshin vulgar që e konsideron letërsinë produkt të thjeshtë të realitetit. Shpjegimi pozitivist i prodhimit letrar simbas parimit të kauzalitetit fizik është i tejkaluar, sepse nuk e merr parasysh rolin e talentit në krijimtari. Megjithëkëtë, faktorët historikë-kulturale te ne kanë përcaktuar në mënyrë të veçantë rrjedhat e përgjithshme të prodhimit letrar: rrethanat e përgjithshme kulturore dhe sociale-politike, sa e shpjegojnë njëra-tjetrën, po aq edhe nivelin e romanit tonë në përgjithësi”.

Në planin e faktorëve letrarë, gjithnjë lidhur me shfaqjen e prozës, përkatësisht romanit në letërsinë shqipe, më tej ai shtron dilemën nëse lëvrimi i romanit erdhi si produkt i imitimit të autorëve nga kultura të tjera letrare, pra nga ajo që e quan si “ndikim nga jashtë”, apo nëse në këtë pikëpamje u ndoq tradita epike e letërsisë sonë, duke e ritheksuar lidhjen ndërmjet epit dhe romanit, përkatësisht nga ajo që e quan “trung origjinal letrar”. Çështjet e këtilla që shtronte një autor, i cili ende nuk i kishte mbushur tri dekada jetë dhe të cilat për shumëçka mbesin të padefinuar edhe sot e gjithë ditën, janë dëshmi e një njohjeje të jashtëzakonshme teorike të problemeve të dijeve letrare, sikundër edhe e

² Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 8.

njohjes së procesit kronologjik të zhvillimit të letërsisë shqipe, të produktit të saj autorial dhe paraautorial. Në këtë pikëpamje epika jonë e pasur, këngët kreshnike, epika historike, baladat popullore etj., sikundër edhe poezia e shkruar epike dhe liriko-epike, e periudhës së romantizmit, janë një fazë pararendëse e zhvillimit të romanit si formë e përafërt strukturale e narrative që është në vijimësinë e tyre.

Pasi ofron një kronologji të shkurtër historiko-letrare, gjithsesi të nevojshme për ta njohur rrugëtimin historik të prozës shqiptare e me theks të veçantë në romanin shqiptar, Bajram Krasniqi ofron aspekte morfologjike dhe sidomos tipologjike të romanit bashkëkohor shqiptar, duke pasur për objekt format letrare, përkatësisht tipat e romanit. Në një tipologji që e bën, sikundër pohon, në vija të trasha, identifikonte dy tipa të romanit bashkëkohor shqiptar: tipin e romanit klasik (me autorë Jakov Xoxën, Shefqet Musarajn, Ali Abdihoxhën, Hivzi Sulejmanin, Nazmi Rrahmanin etj.) dhe tipin e romanit modern (me autorë Ismail Kadarenë, Anton Pashkun dhe Rexhep Qosjen), kuptohet bazuar nësinë ideo-tematike, strukturën e brendshme dhe skemën kompozicionale. Bajram Krasniqi, duke qëndruar larg dogmatizmit teorik, përfundimet e tij përpiqet t'i konkretizojë me fakte letrare, me vepra dhe me autorë, duke i qartësuar konceptet e tij dhe duke i bërë ato të verifikueshme dhe referenciale për studiuesit e tjerë.

Përgjithësisht, pjesa hyrëse e këtij libri karakterizohet nga konstatimet e qëndrueshme të Bajram Krasniqi lidhur me aspekte zhvillimore, historiko- letrare, morfologjike e tipologjike të prozës shqipe. Konceptet janë të qarta dhe të shprehura saktë në aspektin terminologjik. Si të tilla, ato do të përbëjnë boshtin studimor në pjesën më të madhe të kësaj vepre, por edhe të tjerave në vitet vijuese. Larg çdo lloj snobizmi dhe galimatias terminologjik, që janë aq të pranishme në studimet tona mbi letërsinë, tekstet e tij janë të shkruara me një gjuhë të qartë dhe me një elokuencë të rrallë logjike.

Modele të prozës shqipe

Shqyrtimi përgjithësues i pjesës hyrëse të kapitullit “Romani – probleme dhe interpretime”, lidhur me prozën shqipe, konkretizohet në shkrimet vijuese të përmbledhura në librin “Komunikime letrare”. Tekstet “Poetika e zhgënjimit”, “Drama sociale e krijuesit”, “Naturalizmi si prosede”, “Parabolë mbi historinë” dhe “Midis sentimentalizmit dhe realizmit” marrin në shqyrtim romanet e disa prej autorëve më të rëndë-

sishëm të autorëve të Kosovës. Ndonëse janë kontribute kritiko-letrare për vepra të veçanta, përkatësisht autorë të veçantë, në to dalin në pah përgjithësimet me interes për rrjedhat e përgjithshme të prozës shqipe. Interpretimi i këtyre romaneve është bërë gjithnjë në një kontekst më të gjerë zhvillimesh letrare shqipe.

“Poetika e zhgënjimit” është shkrimi kritik që merr në shqyrtim prozën e Hivzi Sulejmanit. Fillimisht, Bajram Krasniqi qartëson aspektin tematiko-motivor të prozës së këtij autori, sidomos për faktin se vepra e tij letrare është letërsi e angazhuar, duke e ndërlidhur angazhimin me vetëdijen e shkrimtarit për të qenë i tillë, pra i angazhuar, shkrim që mban qëndrim aktiv në raport me realitetin politik dhe shoqëror. Nisur nga fakti se Hivzi Sulejmani është një individ dhe artist i angazhuar në rrjedhat shoqërore, një faktor aktiv e reagues ndaj tyre, por edhe një idealist, një ëndërrimtar i madh, i cili ishte përballur me zhgënjimin në raport me atë çfarë kishte pritur në zhvillimet shoqërore, poetika e tij, më parë se në sferën e letërsisë kërkohet në dimensione jashtëletrare. Konteksti historiko-shoqëror dhe realiteti i kohës që e jeton autori formësojnë një poetikë, një poetikë përbërës specifikë të saj: “Tema më e dashur në gjithë opusin letrar të Hivzi Sulejmanit është aspekti etik i ekzistencës së njeriut në kushte konkrete historike-shoqërore. Sado që ky aspekt vështrohet në rrafshin doktrinar, të cilin në prozë e pasqyron eseistika publicistike, në pasazhet lirike dhe meditimet e shumta të personazheve të ndryshme manifestohet edhe konceptimi personal i strukturës etike të njeriut, i anatomisë së sa, përmes një entuziazmi dashuror ndaj bukurisë morale, që për shkrimtarin është vlera e parë njerëzore. Ai brengoset për humanitetin e njeriut të vënë në situata ekzistencialisht të luhatshme në botën e sotme, në të cilën qëllim kryesor është paraja dhe komoditeti. Për këtë arsye ëndrra e iluzionit, idealet etike dhe estetike ndeshen me realitetin e vrazhdë. Në të vërtetë ëndrra, iluzioni, arti, lakmia, makutëria janë fjalët tematike të kësaj proze”³. Për analizën e veçantisë së tregimit të Hivzi Sulejmanit, në pjesën e parë të kësaj kritike letrare që ka edhe elemente të mirëfillta të studimit, Bajram Krasniqi është mbështetur në tri tregime të këtij autori: “Qetësi deti”, “Miku im Xho” dhe “Re e mllefur”. Në një tekst të përmbledhur janë sjellë tipare interesante strukturore, ideore, tematike, pastaj të raportit autor-personazh dhe më tej perceptuesi, përkatësisht lexuesi i tyre. Pjesa e dytë e këtij shkrimi titullohet “Romani si antimit”, ndërsa për analizë është marrë romani “Fëmijët e lumit tim”.

³ Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 24.

Në këtë vështrim kritiko-letrar autori vë në pah specifikat e romanit të Hivzi Sulejmanit si njëri ndër autorët e parë të prozës shqipe në Kosovë, por edhe ndër penat që identifikohet edhe në tipologjinë e tij letrare ndër përfaqësuesit e tipit të romanit klasik. Një veçanti tjetër e tij ka të bëjë me qëndrimin e autorit (i mishëruar në personazhin e Bardhit) në raport me botën, me vizionin e tij mbi çështje ekzistenciale dhe etike të individit në një shoqëri që bazohej në idealet e revolucionit, në përpjekjet për ta çmitizuar rolin e faktorëve të mëhershëm në shoqëri etj. Bajram Krasniqi u kushton vëmendje edhe përbërësve të tjerë përmbajtjesorë e ligjërimorë të romanit, por do të thosha se esenca e vlerësimit të kësaj vepre në prozë të Hivzi Sulejmanit mund të përmblihet në këto fjalë: “Vështrimi i poetikës së prozës së Hivzi Sulejmanit shpjegon shumë aspekte të romanit “Fëmijët e lumit tim”. Si kultivues i fjalës së shkruar në zhanre të ndryshme letrare, ky shkrimtar manifeston unitetin e vizionit poetik mbi botën. Në të gjitha veprat e tij manifeston bindjen se arti letrar duhet të shtrojë në formë problemore çështjet më qenësore të ekzistencës historike të njeriut. Këtë bindje ai e realizon me mjete të ndryshme artistike dhe jo me një gjuhë poetike që është krejt e vetja. Sado që në teksturën letrare ndikojnë tiparet e zhanrit, në ligjërimin poetik vërehet njësia strukturale, jo vetëm midis formave epike të shprehjes, por edhe midis poezisë dhe dramës”⁴.

Shkrimi vijues kritiko-letrar, kushtuar romanit “Vdekja më vjen prej syve të tillë” të Rexhep Qosjes, krahas vlerësimit tejet origjinal për njëri ndër veprat që shënon kthesë në prozën shqipe, ofron dëshmi të kapaciteteve njohëse teorike dhe historiko-letrare të Bajram Krasniqit në fushën e studimeve letrare. Përcaktimi zhanror dhe tipologjik i kësaj vepre në prozë përbën diskutimin themelor të autorit, i cili konsideron se ky roman nuk përfill poetikën e romanit klasik as në planin strukturor dhe as në atë tipologjik. Në planin narratologjik ai identifikon njëjtësimin ndërmjet autorit dhe narratorit që shpërfaqet në personazhin e shkrimtarit Gjezairi i Gjikës. Më tej, Bajram Krasniqi e vë në plan krahasues këtë roman me romane të autorëve të tjerë të letërsisë botërore, duke e vënë theksin tek aspektet risimtare kundruall traditës sonë letrare. Përgjithësisht teksti “Drama sociale e krijuesit” është ndër vlerësimet më objektive dhe më sintetizuese për një vepër letrare që solli një stil të ri dhe një formë të re në letërsinë shqipe, madje në një fazë të klishezimit të saj socio-realist, për një roman që u shqua me veçantitë e tij në rrafshet

⁴ Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 28-29.

struktorore, tipologjike dhe tematike. Bajram Krasniqi në këtë shkrim kritiko-letrar dëshmon kapacitetet e rralla vlerësuese, të bazuara, veçse në talentin e tij, edhe në njohjen e poetikave të letërsisë, por edhe të trashëgimisë letrare shqipe dhe sidomos të asaj botërore. Larg glorifikimeve himnizuese, që shfaqen si veçori e kritikës letrare socio-realiste, analiza e përmbajtjes së kësaj vepre përbën një model të ri të interpretimit të totalitetit të një vepre letrare, ndërsa sintezat e tij janë dëshmi e identifikimit të esencave të veprës letrare, por edhe të vendit të saj në një sistem të gjerë sikundër është letërsia shqipe, veçmas ajo e krijuar në Kosovë.

Shkrimi për romanin e Ramiz Kelmendit “Shtatë persona ndjekin au-torin” vë theksin te raporti i autorit me realitetin, te mënyra e veçantë e qasjes ndaj tij dhe një prosede që shpërfaq mënyrën origjinale të krijimit të një vepre letrare. Bajram Krasniqi përqendrohet te këto aspekte karakterizuese të romanit të Ramiz Kelmendit, i cili duke mos bërë përgjithësime karakterologjike të personazheve, i identifikon personat e një shoqërie dhe i bart në mënyrë veristike në romanin e tij. Kjo është e veçanta karakterizuese e romanit të Ramiz Kelmendit, i cili në këtë format nuk i formëson, nuk i stilizon dhe aq më pak i idealizon situatat, tablotë jetësore dhe karakteret. Përzgjedhja e situatave konkrete dhe e tipave konkretë nga jeta, pa një synim të qartë për të krijuar përgjithësime, sipas Bajram Krasniqit, e bën më të theksueshëm karakterin subjektivist të autorit-narrator. Si vlerë tjetër të këtij romani ai e çmon edhe ironinë dhe humorin e zi. Natyrisht, sikundër edhe vështrimet e tjera kritiko-letrare ai merret edhe me aspekte kompozicionale të romanit, me veçantitë e tij stilistike, narratologjike etj., gjithnjë duke ofruar një pamje tërësore mbi vlerën e tij letrare.

Romanin “Dhuna” të Rexhep Zogajt, që trajton një periudhë të vështirë të jetës së shqiptarëve, atë të mes dy luftërave botërore, Bajram Krasniqi e ka karakterizuar si letërsi dokumentare. Dokumentariteti i saj është parë si një parabolë mbi periudhat historike, si fabula paralele, si evokim i të kaluarës që vjen në trajtë monologjesh, kujtimesh dhe si përjetim i së tashmes të autorit, i kohës së rrëfimit të të ndodhurave. Autori i romanit, me gjithëpraninë e tij në veprën letrare, sipas Bajram Krasniqit, shndërrohet në një përbërës të rëndësishëm të saj: “Figura e autorit paraqitet në çdo detaj të tekstit, por iluzorisht e shohim të mishëruar në disa personazhe, në radhë të parë në Lekë Lumëbardhën, i

cili mund të konsiderohet edhe hero-ideolog”.⁵ Në këtë vështrim kritiko-letrar, sikundër edhe në shumë të tjera të mëpastajme dhe veçmas në monografinë “Poetika e romanit historik shqiptar”, Bajram Krasniqi dëshmon njohjen e rrallë të raporteve ndërmjet letërsisë dhe historisë, ndërmjet fikcionit dhe dokumentaritetit. Po kështu, ai ka vlerësuar se në këtë roman vërehet një ndikim i qartë, në planin e ndjekjes së një modeli letrar, të romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” të Ismail Kadaresë.

“Midis sentimentalizmit dhe realizmit” është shkrimi kritiko-letrar i radhës i përfshirë në vëllimin “Komunikime letrare”, në të cilin merr në shqyrtim romanin “Mbas vdekjes” të Nazmi Rrahmanit, të evidentuar këtu dhe në shkrime të tjera si njëri ndër autorët e romanit klasik në letërsinë shqipe. Që në fillim, Bajram Krasniqi konstaton se bëhet fjalë për një roman me poetikë duale dhe deri diku edhe të ndryshme nga ajo e romaneve të tjera të Nazmi Rrahmanit. Veprimet e ndërlikuara dhe të ndërlydhura, që e përbëjnë intrigën në romanet e këtij autori këtu nuk dalin në rend të parë, ngase ai – sikundër vëren me të drejtë Bajram Krasniqi – fokusohet në përshkrimin e botës së brendshme të personazhit që ndodhet para udhëkryqeve e dilemave të mëdha jetësore. Rrëfimi i ndodhive, që në romanin klasik zbulojnë kundërshtitë e mëdha të personazheve, i lë më shumë vend përshkrimit të botës emocionale të personazhit kryesor, Hazirit. Ky përshkrim i psikës së njeriut natyrshëm shpie në dimensione emocionale që janë tipike për perceptimin sentimentalist të botës. Mbase esenca e krejt këtij vlerësimi kompleks për një autor të rëndësishëm të romanit shqiptar mund të përmblihet në fjalët e autorit të kësaj kritike letrare: “Autori në këtë roman shfrytëzon edhe trajtat tradicionale edhe trajtat moderne për konstituimin e botës letrare, aq sa vepra, herë e pason realitetin, e herë synon të bëhet realitet vetë”.⁶

Përgjithësisht kaptina e parë e këtij libri, me pjesën e vet hyrëse – përgjithësuese, e cila është kryesisht e karakterit historiko-letrar dhe me shkrimet kritiko-letrare për vepra të autorëve të caktuar të prozës së shkruar në Kosovë (Hivzi Sulejmani, Rexhep Qosja, Ramiz Kelmendi, Rexhep Zogaj dhe Nazmi Rrahmani) është dëshmi e kapaciteteve studimore, interpretuese e vlerësuese të Bajram Krasniqit që në nismën e shkrimeve mbi letërsinë, e një potenciali të mirëformuar teorik, të një njohjeje të mirë të kronologjisë letrare shqipe dhe mbi të gjitha të një talenti në identifikimin dhe në shpjegimin e vlerave letrare. Duke u

⁵ Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 55.

⁶ Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 63.

përcaktuar për çështje të rëndësishme dhe për autorë e vepra të prozës shqipe, përkatësisht të romanit shqiptar, të shkruar në Kosovë, Bajram Krasniqi e ka dëshmuar zotësinë e përdallimit të asaj që është esenciale në zhvillimin kronologjik të letërsisë shqipe.

Proza e Kadaresë në interesimet studimore të Bajram Krasniqit

Ndonëse është i njohur gjithandej fakti se “Poetika e romanit historik shqiptar” është kryevepra studimore e Bajram Krasniqit, projekti i tij më i rëndësishëm i realizuar në kuadër të punës 14-vjeçare në Institutin Albanologjik, njëkohshëm teza e tij e doktoratës, do thënë se interesimet e tij për prozën shqipe nisin më herët. Krahas shkrimeve kritiko-letrare dhe historiko-letrare që u përfshinë në veprën e tij të parë “Komunikime letrare”, e për të cilat thamë diçka në pjesën pararendëse të këtij kapitulli, pjesa e dytë e këtij libri përbëhet nga studimi i tij për prozën e Ismail Kadaresë. Në të vërtetë, rreth 100 faqe tekst i janë kushtuar prozës së Ismail Kadaresë, e që përbëjnë temën e tij të magjistraturës të titulluar “Stili i prozës së Ismail Kadaresë” që e kishte të mbrojtur më 1978. Është e kuptueshme që, në formatin e botuar, teksti i këtij studimi monografik të ketë pësuar ndonjë ndryshim, edhe për shkak të rishikimit e të plotësimit të materies së trajtuar. Vetë riformulimi i titullit në “Poetika e prozës së Ismail Kadaresë” është dëshmi në këtë pikëpamje.

Në ditët e sotme mund të evidentojmë një numër të konsiderueshëm veprash studimore që e kanë marrë në shqyrtim veprën e Ismail Kadaresë, por do thënë se në kohën kur pa dritën e botimit, studimi i Bajram Krasniqit, bibliografia studimore për veprën, veçmas prozën, e autorit më të përkthyer (edhe në atë kohë) shqiptar ishte e paktë. Duke e vlerësuar si personalitet identifikues të letërsisë shqipe, duke çmuar si një autor që me prozën e tij ia dilte të shmangte stampën, që e impononte dogma e realizmit socialist, Bajram Krasniqi fokusohet tek aspekte të poetikës së këtij autori. Studimi ka një strukturë interesante, e bukur përfshirëse, të konceptuar në disa kapituj të veçantë, sikundër janë: “Kadareja si poet dhe prozator” (që përbën kapitullin hyrës dhe qartësues lidhur me unitetin e vizionit të këtij krijuesi letrar), kapitulli i dytë është “Përmbajtja në nocionet e saj”, për të vijuar me kapitullin “Raporti i rrëfimit”, pastaj me kapitullin “Thënia poetike”, ndërsa kapitulli i fundit titullohet “Ndikimet”. Merret vesh, si një studim serioz dhe shumë i rrallë

për kohën, kjo sprovë monografike e Bajram Krasniqit është e pajisur edhe me një përfundim, në të cilin ai përmbledh rezultatet e tij kryesore.

Nisur nga fakti se Ismail Kadare përbënte që atëherë një individualitet në letërsinë shqipe, Bajram Krasniqi identifikon një qëndrim ndryshe të shkrimtarit të periudhës së realizmit socialist, parë nga këndvështrimi i përgjithshëm e mbizotërues i atij që ai e quan “realizëm i rrafshët”. Ai më tej e konsideron realizmin e shkrimtarit tonë të shquar si “realizëm i hapur” si realizëm që bashkëjeton me ekzistencializmin. Natyrisht, duke e konsideruar raportin e shkrimtarit ndaj njeriut si një raport esencial që shfaqet në veprën e tij letrare, ai e vë shkrimtarin tonë jashtë skemave të kohës, mbi të cilat ngriheshin, në një raport shëmbëllimi epigonist, veprat letrare: “Kadareja njeriun nuk e vështron vetëm si qenie shoqërore, por edhe si individ me dilema të natyrshme psikologjike dhe etiko-morale. Ky aspekt i vështrimit të njeriut i paraqitur përmes narracionit induktiv, i cili është element kryesor në prozën e Kadaresë e dallon nga pjesa dërrmuese e romanit tonë të sotëm të realizmit të rrafshët. Si individ shikohet edhe martiri edhe i ligu, edhe heroi edhe servili, edhe mundësi edhe i munduri, por pa u vënë ballaballë në mënyrë mekanike”.⁷

Bajram Krasniqi shkurtazi përshkruan rrugën krijuese letrare të Ismail Kadaresë, duke vënë në pah faktin se këtë rrugë e kishte nisur në fushën e poezisë, për të vijuar më suksesshëm në prozë dhe sidomos në roman. Po ashtu, janë dhënë edhe aspekte të evoluimit të mendimit rreth Kadaresë në dimensionin akseologjik, që në mendimin tonë kritiko-letrar zë fill me konstatimin fillestar për një autor që premtion, por i cili qortohet për arsye të ndikimeve të paasimiluara (vlerësime me rastin e botimit të përmbledhjes së parë poetike “Frymëzime djaloshare”) e deri tek autori që “shënon nivelin e ri artistik dhe pjekurinë poetike-estetike të letërsisë shqiptare”.⁸

Uniteti i vizionit poetik, si hallkë që ndërlihd aspekte të ndryshme zhanrore të veprës letrare të Ismail Kadaresë dhe si vetëdije intelektuale e estetike e tij, është identifikuar nga Bajram Krasniqi si pikëshikim i veçantë i shkrimtarit tonë mbi botën dhe njeriun. Vizioni i Kadaresë, i bazuar në konceptacionin humanist, e ndërlihd veprën letrare me angazhimin misionar shoqëror dhe sidomos në krijimin e një raporti specifik me historinë.

⁷ Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 155.

⁸ Po aty, f. 153.

Një vëmendje të veçantë Bajram Krasniqi ia ka kushtuar lëndës letrare të prozës së Ismail Kadaresë. Nisur nga definimi kajzerian, sipas të cilit lëndë e një vepre letrare është çdo gjë që funksionon jashtë veprës letrare, por që e ndikon atë (pra veprën letrare, përmbajtjen e saj), autori i monografisë “Poetika e prozës së Ismail Kadaresë” identifikon tri burime lëndore të prozës së Kadaresë: mitologjinë, historinë dhe realitetin. Lënda në këtë kuptim konceptohet si burim i shkruar, ose edhe i pashkruar, ndërsa rëndësia e saj për formatin letrar artistik të prozatorit tonë ka të bëjë me faktin se sa dominant shfaqet njëri ose tjetri burim. Gjithsesi, në rastin e romanit “Kështjella”, por edhe të romaneve të tjera me temë historike, dalin në pah edhe aspekte mitologjike, duke e identifikuar (krahas përcaktimit tipologjik si një roman historik) edhe si një roman me përbërës të caktuar alegoriko-simbolikë etj. Më tej është marrë edhe me aspekte të motivikës së veprës së Ismail Kadaresë, duke qartësuar raportin ndërmjet temës dhe motivit në veprën e tij: “Motivi shpesh herë në veprën e Kadaresë përputhet me temën. Mirëpo, edhe këso rasash ekziston dallimi midis tyre, për arsye se tema, si nocion letrar, i përket sferës së idealitetit, ndërsa motivi është situata konkrete tipike, e cila ka mundësi përsëritjeje në kohë dhe në hapësirë të ndryshme. Kësodore, për të parë dallimin midis temës dhe motivit në prozën e Kadaresë, po nisemi nga romani i parë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”. Tema e këtij romani do të thosha se është karakteri i drejtë dhe i padrejtë i luftës, ndërsa motivi është qëndresa kundër agresionit të huaj...”⁹ Përgjithësisht, bazuar në analizën e Bajram Krasniqit, del se motivika e veprës së Kadaresë sajohet nga një tërësi motivesh interesante dhe të përsëritshme, por të ndërlidhura fuqishëm me kontekstin kohor dhe hapësinor, gjë që i bën të veçanta në aspektin ontologjik, sidomos kur bëhet fjalë për tipizimin e karaktereve të ndryshme në veprën e tij letrare. Një aspekt tjetër i studimit të prozës së Ismail Kadaresë ka të bëjë me fabulën. Sipas autorit ajo shfaqet si një variabël që përfshin fabulën nga formati i saj klasik e deri te fabula e reduktuar dhe fabula si mozaik letrar. Në të vërtetë, fabula shfaqet në varësi të asaj se sa akëcili roman i Kadaresë qëndron më afër llojit të romanit klasik ose atij modern. Sikundër edhe në raste të tjera, përfundimet e Bajram Krasniqit lidhur me materien studimore janë të konkretizuara nëpërmjet sjelljes së shembujve, përkatësisht nëpërmjet mbështetjes në tipologjinë e veprave letrare të romancierit tonë.

⁹ Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 96.

Përveçse në planin e motivikës dhe të fabulës, një veçanti e romaneve të Ismail Kadaresë, sipas studimit monografik të Bajram Krasniqit, ka të bëjë edhe me aspekte narratologjike. Raporti ndërmjet autorit dhe narratorit përbën njërën ndër çështjet parësore të trajtuara lidhur me romanet e Kadaresë. Janë identifikuar rastet kur autorin e gjejmë të njëjtësuar me narratorin, përkatësisht kur personazhi bëhet përçues i ideve a pikëpamjeve të autorit. Interes përbën edhe shqyrtimi mbi narratorin si subjekt fiktiv i autorit, sikundër edhe ai mbi perspektivën e shumëfishtë narratologjike, përkatësisht lëvizjen e narratorit nga një personazh në një personazh tjetër. Më tej një vëmendje i është kushtuar edhe relacioneve narratori – personazhet dhe narratori – lexuesit.

Një aspekt tjetër interesant që dallohet në romanet e Kadaresë, sipas Bajram Krasniqit, ka të bëjë me gjuhën dhe stilin e veprës së tij. Është e qartë se, edhe pse në veprën e tij gjuhës ia përshkruan, në rend të parë, karakterin funksional, Kadareja ia del ta krijojë stilematikën e tij, si tërësi e stilemave (veçmas të morfostilemave dhe fonostilemave), duke e bërë të dallueshme veprën e tij letrare në planin e veçantisë shprehëse gjuhësore. Merret vesh, sikundër edhe në raste të tjera dhe me qëllim të argumentimit shkencor, vlerësimi mbi nuancimin dhe kontekstualizimin e gjuhës qartësohet nëpërmjet shembujve të nxjerrë nga romanet e shkrimtarit tonë. Po kështu, në këtë kaptinë të studimit një vëmendje i kushtohet monologut dhe dialogut në romanet e Ismail Kadaresë, duke ofruar modelet më përfaqësuese të tyre (monologu direkt, monologu indirekt; dialogu që pasqyron prirje antagoniste, dialogu që pasqyron prirjet joantagoniste, replikat etj.).

Ndikimet letrare kanë qenë përherë në vëmendjen e studiuesve të letërsisë. Marrëdhëniet ndërmjet veprave letrare të autorëve dhe të kulturave letrare, në një plan më të gjerë, janë një fakt që nuk mund të anashkalohej dhe një faktor me interes i ndërveprimit. Faktet e evidencuara, që hasen të bartura nga një autor te tjetri, shpeshherë kanë shpënë në trajtime pozitiviste, me çka është ngushtuar hapësira e studimit ndjeshëm dhe janë klishezuar edhe kontributet historiko-letrare dhe kritiko-letrare. Përkitazi me ndikimet në letërsi Bajram Krasniqi shpreh këtë pikëpamje: “Studimi i ndikimeve të ndërmjetvjetshme të shkrimtarëve ka argumentuar edhe të dhënë tjetër, e cila në kohën tonë jo rrallë nuk merret parasysh, se ndikimet në krijimtarinë letrare janë evidente dhe të pamohueshme në krijimtarinë e çdo shkrimtari. Kësodore, aty ku për arsye të mosinformimit letrar-kultural, konstatohet origjinaliteti i krijuesit në të vërtetë është ndikim nga një shkrimtar tjetër, që edhe në këtë rast

nuk ul vlerën e krijimtarisë së tij, natyrisht po të jetë i asimiluar”¹⁰. Megjithëse që në krye të herës konstaton se Kadareja është autor të cilin e shquan origjinaliteti dhe forca kreative, Bajram Krasniqi e vë në relacione krahasimi prozën e autorit tonë, duke identifikuar disa linja të ndikimit nga autorë të shquar botërorë. Fakti se njeh poetika të ndryshme të letërsive evropiane e botërore, se ka asimiluar modele dhe aspekte të ndryshme nga autorë elitarë të letërsisë së përbotshme, se u ka dhënë fakteve të bartura letrare ngjyrimin e artit vetjak letrar, ka bërë që Ismail Kadare të mos bjerë në pozitat e një autori epigon, i cili verbërisht ndjek një model të caktuar letrar. Gjurmët e ndikimeve të autorëve dhe të veprave, të cilat romancieri ynë i kishte lexuar, janë evidentuar nga studiuesi Krasniqi, duke i vënë në korrelacione konkrete ato. Bie fjala, letërsia ruse dhe sovjetike shënon një potencial ndikues në veprën e Kadaresë edhe për faktin se autori ynë u formua, në rrafshin artistik letrar dhe akademik letrar, në kontekstin e studimeve në Institutin “Gorki” të Moskës. Autorët si Gogoli, Gorki, Majakovski dhe Dostojevski janë parë si burime të ndikimit dhe të formësimit të veprës së Kadaresë në aspekte të ndryshme. Megjithatë, ka edhe autorë të tjerë, shenja të ndikimit të të cilëve hetohen në veprën e Kadaresë, qoftë si aspekte të poetikës, qoftë të ideve, të tematikës, të organizimit struktural të veprës etj., ndër të cilët Bajram Krasniqi veçon Kafkën, Prustin, Xhojsin dhe Heminguejin, ndërkaq te një kategori tjetër autorësh marrëdhënien e prozatorit tonë e ka identifikuar si afri letrare, si analogji letrare (pra jo si ndikim), e ku bëjnë pjesë Floberi, Stendali, Bucati, Holderini etj. Pavarësisht pikëtakimeve të shumta me përfaqësues të letërsive të tjera, përkatësisht të letërsisë së përbotshme, Bajram Krasniqi e thekson si të padiskutueshëm subjektivitetin dhe origjinalitetin e Kadaresë si shkrimtar: “Kadareja është krijues me erudicion të gjerë dhe me fuqi kreative të madhe. Ndikimet që pranon nga shkrimtarët e ndryshëm i përpunon në laboratorin e vet krijues, i përvetëson në mënyrë krijuese dhe i bën vlera plotësisht origjinale”¹¹. Duke mos e zgjedhur një subjekt të caktuar letrar, duke mos e pasur në gjithçka një autor, mund të thuhet se në karakterin polimorf të veprës së Kadaresë kanë ndikuar burimet e shumta dhe të ndryshme të formimit të tij letrar.

¹⁰ Po aty, f. 143-143.

¹¹ Bajram Krasniqi, *Komunikime letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 152.

Përgjithësisht mund të thuhet se studimi monografik i Bajram Krasniqit, i titulluar “Poetika e prozës së Ismail Kadaresë”, veçmas kundruar në planin e kohës së punimit dhe të botimit të tij (1978-1980), përbën sprovën e parë serioze sintetizuese për vlerat letrare të prozës së shkrimtarit më të njohur shqiptar në planin kombëtar dhe përtej tij. Përtej kësaj, edhe sot ky studim, disi i harruar nga studiuesit e mëpastajmë të Kadaresë, mbetet ndër kontributet më domethënëse në studimet për veprën e tij letrare. Duke identifikuar përbërës të rëndësishëm të kësaj proze, Bajram Krasniqi ka nxjerrë në pah, me një gjuhë adapte të shkencës së letërsisë dhe me një metodologji moderne shkencore, vlerat dhe veçantitë më të rëndësishme të saj.

Përfundim

Si studim monografik “Poetika e prozës së Ismail Kadaresë” përbën prologun shkencor të kryeveprës së tij “Poetika e romanit historik shqiptar”, përkatësisht paradigmen e saj historiko-letrare dhe kritikoletrare në planin e interpretimit të lëndës letrare, të argumentimit logjik dhe të sintetizimit të mendimit shkencor, të përdorimit të terminologjisë letrare, të zbatimit të metodologjisë studimore moderne etj., është një paralajmërim për shfaqjen e një dijetari të rrallë në studimet tona letrare dhe të një autori të spikatur të kritikës sonë letrare, i cili ia del të dallojë të veçantën nga e përgjithshmja, fenomenin e ri letrar nga stampa mbi-zotëruese letrare.

Përgjithësisht vepra “Komunikime letrare”, me të dy pjesët e saj strukturore, përbën hapin e parë, por të sigurt të studiuesit dhe të kritikut letrar, Bajram Krasniqi, për formimin e një timologjie specifike letrare (që, për hir të së vërtetës, do thënë se nuk identifikohet as me ndonjë pararendës dhe as pati ndonjë vazhdimtar në këtë pikëpamje), formimin e “një sistemi akseologjik”, të cilit i nënshtrohet lënda studimore, pavarësisht nëse bëhet fjalë për autorë më pak ose më shumë të njohur, pavarësisht nëse këto shkrime vijnë në një format të kritikës letrare, apo nëse vijnë në një format të studimit shkencor monografik. Talenti i rrallë dhe përgatitja teorike e duhur e Bajram Krasniqit, krijimi i një sistemi parimor e shkencor mbi vlerat letrare, që në krye të herës – që në veprën e parë, ia kanë bërë të mundur një koherencë mendimi, një vizion të qartë mbi trashëgiminë letrare shqiptare, jo rrallë të parë edhe në kontekste më të gjera të trashëgimisë letrare botërore.

LITERARY TIMOLOGY OF BAJRAM KRASNIQI

Summary

As a monographic study “The Poetics of Ismail Kadare's Prose” constitutes the scientific prologue of his masterpiece “The Poetics of the Albanian Historical Novel”, namely its historical-literary and critical-literary paradigm in terms of the interpretation of the literary material, logical argumentation and synthesis of scientific thought, the use of literary terminology, the employing of modern study methodology, etc., it is a warning of the appearance of a rare scholar in our literary studies, and of a prominent author in our literary criticism, who succeeds at distinguishing the particular from the general, of the new literary phenomenon from the prevailing literary norms.

Generally, the work “Literary Communications”, consisting of two structural parts, constitutes the first yet significant step of the researcher and literary critic, Bajram Krasniqi, towards establishing a specific literary timology. Hence, for the sake of truth, it should be noted that this is neither identified with any predecessors, nor has it had successors in this regard. The establishment of an “axiological system” to analyze the research subject, regardless of if it involves less or well-known authors or literary works coming in various formats of literary criticism, or if they come in a format of a monographic scientific research. Exceptional talent and proper theoretical background of Bajram Krasniqi and establishment of a principled and scientific system on literary values right from the outset – from the very first work, has enabled a coherent thought process and a clear perspective on the Albanian literary heritage, which is often seen in the broader context of the world literary heritage.

